



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANE SH.A.
DEPARTAMENTI I SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORIA E PROKURIMEVE

Nr. _____ Prot.

Tiranë , më ____/____/2018

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Për: **“R.S.&M” shpk**

1.1 Procedura e prokurimit: **“Kërkesë për propozime- Mallra”**

1.2 Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-72844-05-31-2018

1.3 Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Blerje Sinjalistika Rrugore”** me fond limit 923.000(nëntëqind e njëzetë e tre mijë)lekë pa tvsh.

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike

1.3 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët ☒ oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. **“dabar” sh.p.k**

L62409033I

Vlera 786.000(shtatëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë)lekë pa tvsh.

2. **“si.si.-al sh.p.k” sh.p.k**

K72117030P

Vlera 805.500(tetëqind e pesë mijë e pesëqind)lekë pa tvsh.

3. **“akm albania” sh.p.k**

L82621403K

Vlera 828.500(tetëqind e njëzetë e tetë mijë e pesëqind)lekë pa tvsh.

4. **“r.s.&m” sh.p.k**

K32203002I

Vlera 847.000(tetëqind e dyzetë e shtatë mijë)lekë pa tvsh.

5. **“idk-konstruksion” sh.p.k**

K51408016J

Vlera 847.500(tetëqind e dyzetë e shtatë mijë e pesëqind)lekë pa tvsh.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. “**dabar**” sh.p.k

L62409033I

Vlera 786.000(shtatëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë)lekë pa tvsh.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Së pari AK në kushtet e veçanta të kualifikimit pika 2 d) ka kërkuar si më poshtë cituar:

d. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të kërkuar në DST operatori ekonomik ka paraqitur në sistemin elektronik vërtetim debie nr.prot 3659,datë 03.05.2018 *lëshuar nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a, në emër të kërkuarit “DABAR” sh.p.k ku evidentohet që: “... nga verifikimet e kryera në Sistemin e Faturimit, për kontratën rezultojnë të ketë në total 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e llogaritur deri në datën 03.05.2018 pa përfshirë faturën koherente të muajit Prill 2018.*

Referuar Nenit 9 (“Pagesa dhe afati për kryerjen e saj”), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me VKM Nr. 109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë”, përcaktohet shprehimisht që: “Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, **jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar.**

Vërtetimi i Debisë i paraqitur në sistemin elektronik nga Operatori ekonomik nuk vërteton shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike për periudhën më të fundit para hapjes së ofertave që tashmë ishte maturuar për procedurën e prokurimit konkretisht **muajin Prill 2018.**

Nisur nga sa më lart, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se operatori ekonomik “DABAR” shpk, nuk plotësojnë Kriteret e Veçanta për Kualifikim pika 1 gërma “d” të vendosur në DST, c’ka bie në kundërshtim me VKM-në Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu III, Seksioni II, Neni 26, pika 7 gërma “c” ku ndër të tjera citohet se “**Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik,** përveç rastit kur rezultojnë se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankiminë gjykatë.”

Gjithashtu vlen të theksojmë se publikimi i procedurës objekt në sistemin elektronik të app-së është bërë në datën 01.06.2018 dhe data e hapjes së ofertave është lënë më datën 11.06.2018 brenda këtij afati operatorët ekonomikë e kishin detyrim të kishin bërë bërë pagesën e faturës së muajit **Prill 2018** si dhe të pajiseshin me vërtetim mbi shlyerjen e të gjitha **detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri kjo theksojmë** Referuar Nenit 9 (“Pagesa dhe afati për kryerjen e saj”), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me VKM Nr. 109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë”, përcaktohet shprehimisht që: “Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, **jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar.** Në

mbështetje të VKM-në Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu III, Seksioni II, Neni 26, pika 7 gërma “c” ku ndër të tjera citohet se “Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankiminë gjykatë”

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se dokumentacioni i paraqitur për përmbushjen e këtij kriteri është i paplotë për rrjedhojë i pavlefshëm.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

2. si.si.-al sh.p.k” sh.p.k

K72117030P

Vlera 805.500(tetëqind e pesë mijë e pesëqind)lekë pa tvsh.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Së pari AK në kushtet e veçanta të kualifikimit kapaciteti teknik pika 1.3 ka kërkuar si më poshtë cituar:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tre viteve të fundit(nga data e zhvillimit të tenderit) me një vlerë sa 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet ose 369.200(treqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e dyqind)lekë pa tvsh.

- Kur furnizimi i mëparshëm i ngjashëm është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar detyrimisht me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e plotë dhe të suksesshëm të kësaj kontrate.

- Kur furnizimi i mëparshëm i ngjashëm është realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë furnizim duke paraqitur faturat përkatëse tatimore ku të jetë shënuar datat, shuma, sasia e mallrave të furnizuara, të nënshkruar nga të dyja palët.

Në përmbushje të kriterit të kërkuar në DST operatori ekonomik ka paraqitur faturën tatimore nr.21, datë 21.05.2015 me palë blerëse Spartaku sh.p.k.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur K.V.O konstaton se fatura e paraqitur nga operatori ekonomik është jashtë afatit të kërkuar në DST si dhe në kundërshtim me rekomandimin e APP datë 20.03.2018 prot 3341/1 .

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se dokumentacioni i paraqitur për përmbushjen e këtij kriteri është i paplotë për rrjedhojë i pavlefshëm.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

3. “akm albania” sh.p.k

L82621403K

Vlera 828.500(tetëqind e njëzetë e tetë mijë e pesëqind)lekë pa tvsh.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Së pari AK në kriteret e veçanta të kualifikimit ka kërkuar kapaciteti teknik pika 1.4 ka kërkuar si më poshtë cituar:

1.4.Operatori ekonomik duhet të deklarojë se mallrat që do të dorëzojë do të jenë sipas specifikimeve teknike.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit në sistemin elektronik operatori ekonomik K.V.O konstaton se operatori ekonomik nuk ka arritur të dëshmojë përmbushjen e kriterit të mësipërm çka bie në kundërshtim kriterin e kërkuar në DST.

Përsa më sipër K.V.O gjykon se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik AKM ALBANIA INVESTEMENT GROUP është I pasaktë dhe për rrjedhojë i pavlefshëm.

Në shtojcën 9 parashikohet se Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

4. idk-konstruksion” sh.p.k

K51408016J

Vlera 847.500(tetëqind e dyzetë e shtatë mijë e pesëqind)lekë pa tvsh.

Së pari AK në kriteret e veçanta të kualifikimit ka kërkuar kapaciteti teknik pika 1.4 ka kërkuar si më poshtë cituar:

1.4.Operatori ekonomik duhet të deklarojë se mallrat që do të dorëzojë do të jenë sipas specifikimeve teknike.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit në sistemin elektronik operatori ekonomik K.V.O konstaton se operatori ekonomik nuk ka arritur të dëshmojë përmbushjen e kriterit të mësipërm çka bie në kundërshtim kriterin e kërkuar në DST.

Përsa më sipër K.V.O gjykon se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik IDK KONSTRUKSION është I pasaktë dhe për rrjedhojë i pavlefshëm.

Në shtojcën 9 parashikohet se Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik **“R.S&M” sh.p.k** se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 847.000(tetëqind e dyzetë e shtatë mijë)lekë pa tvsh pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë UKT sh.a sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do t’ë procedohet siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **13.06.2018**

Ankesa: **JO**

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Redi MOLLA

